

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Violeta Namani dhe Zyrtarja Ligjore Selvete Cakolli, në çështjen penale, kundër të pandehurës L. S. 1 për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2588/2016, të datës 13.01.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor-dënim me gjobë, gjykata jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 24.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr 2588/2016, të datës 13.01.2016, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Te pandehurës – L. S. 1 e bija e F. nezes E. ,mbiemri i vajzërisë së nënës B. i lindur me *data e lindjes...* me vendbanim në rr. “...” nr.... në P. ku edhe jeton tani me nr personal *numri personal...* i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Rep. së Kosoves,

SEPSE

Me datën.06.05.2016 rreth orës 00:20 në udhëkryqin që lidhe rrugët “...” dhe rrugën “...” në P. derisa e pandehura L. S. 1 ishte duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes 140 A” ngjyre të kuqe me targa të regjistrimit *numri i targave...* nga pakujdesia ,duke menduar me mendje lehtësi se nuk do të rrezikoj komunikacionin ,nuk i është përmbajtur rregullave në komunikacion duke e rrezikuar jetën e njerëzve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 34.1 të LSKRR-se e cila duke lëvizur në rrugën “...” duke mos respektuar shenjat e komunikacionit, Kthimin e obliguar djathtas dhe gjate kthimit dhe gjate kthimit majtas me të kyçur në rrugën “...” me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin “VW Caddy” ngjyre e bardhe me targa të regjistrimit *numri i targave...* në anësoren e parë të anës së majte të cilën drejtonte P. G. i cili ishte duke lëvizur në shiritin e majte të rrugës me rast lëndime të lehta trupore pëson drejtuesi i automjetit “VW Caddy” P. G. dhe pasagjeri në automjetin e tij “VW Caddy” B. S. dhe pasagjeret në automjetin “Mercedes140 A” L. S. 2 “L. S. 3 dhe D. S. si dhe shkaktohet aksident komunikacioni me dëme materiale,-

Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së.

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 € (dyqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim, i akuzuari L. S. 1 obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre (3) muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi- urdhri ndëshkimor.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burg, duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës, aq sa do të behete sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ekspertizën e komunikacionit shumen prej **40.88 €**. dhe

ekspertizën mjeko-ligjore ne shumë pre **50.00** euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej **njëzet (20) €**.

Te dëmtuarit – P. G. me vendbanim ne rr.”...” nr... P. L. dhe L. S. 3 me vendbanim ne rr.”...” nr... dhe B. S. me vendbanim ne rr. “...” në P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne konteste te rregullte juridiko-civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. 2588/2016, të datës 13.01.2016, e ka akuzuar, L. S. 1 për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par 6 lidhur me par 1 te KPRK-së, dhe nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimorë-dënim me gjobë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se e akuzuara, vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-s, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura aktakuzës në shkresat e lëndës, dhe atë: ekspertiza mjeko-ligjore e datës 17.12.2016 dhe ekspertiza e ekspertit te komunikacionit e dt.13.06.2016 foto dokumentacioni me shkresat tjera te lendes, janë prova te besueshme mbi bazën e te cilës vërtetohet se i pandehuri, ka kryer veprën penale për të cilën për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor si në dispozitiv të këtij Aktgjykim-Urdhri Ndëshkimor.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450, të KPPK.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 KPPK-së pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.68/17, datë. 24.07.2017.

**Zyrtarja Ligjore,
Selvete Cakolli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Violeta Namani**

KËSHILLË JURIDIKE:

I pandehuri ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimorë, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim .